



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E SHTIMES

Komisioni për shqyrtimin e ankesave në sektorin e Arsimit
Nr.05-610/01-1765/22 datë:12.05.2022



Npi – 01/115 datë: 13.05.2022

Bazuar në nenin 17 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008); Nenin 5 pika (c) të Ligjit, për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës Nr.03/L-068; Nenin 131 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031; Si dhe në bazë të Vendimit të Kryetarit të Komunës për themelimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave në sektorin e Arsimit Nr.02/11 të datës 25.01.2022; Komisioni për shqyrtimin e ankesave në sektorin e arsimit në mbledhjen e mbajtur më 13.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

PËR REFUZIMIN E ANKESËS TË ARDITË GASHI

I

Komisioni për shqyrtimin e ankesave në sektorin e arsimit në mbledhjen e -IV- për vitin 2022 të mbajtur më 13.05.2022, unanimisht vendosi të REFUZOI, Ankesën Nr.05-610/01-9254/22 datë: 08.04.2022, të znj.Arditë Gashi, Adresa: Rr.”Idriz Ajeti” p.n. Pjetërshticë. Mbetet në fuqi vendimi i Drejtorisë Komunale të Arsimit Nr.05/225 i datës 01.04.2022.

II

A r s y e t i m: znj.Arditë Gashi - Pjetërshticë, është ankuar në Vendimin e Komisionit përzgjedhës Nr.05/225 të datës 01.04.2022, sipas Konkursit të shpallur nga Drejtoria Komunale për Arsim më datën 02.02.2022 për vendin e punës Edukatore në IP “Albiona Asllani” në Shtime, ku ka theksuar se i është bërë e pa drejtë sepse nuk është marrë parasysh përvoja e punës e as nuk është marrë parasysh vlera e Institucionit ku kam mbaruar studimet në UP-fakulteti i edukimit, ndërsa kandidatja e pranuar është diplomuar në AAB. Komisioni i Ankesave ka konstatuar se ankesa është paraqitur në afatin e paraparë. Komisioni po ashtu ka konstatuar se çështja e vlerësimit të përvojës së punës është në diskrecionin e Komisionit vlerësues, për të vlerësuar me pikë, dhe pikët totale për Arditë Gashin janë 127.7 ndërsa kandidatja e pranuar ka marrë gjithësej 152 pikë totale. Sa i përket çështjes së dytë se nuk është marrë parasysh vlera e Institucionit universitar, Komisioni unanimisht ka konstatuar se nuk është në kompetencën e Komisionit të vlerësoi kredibilitetin e institucioneve arsimore publike dhe atyre private.

III

Udhëzim për mjetin juridik: Pala ka të drejtë, bazuar në nenin 74 pika 2 e Ligjit për zyrtarët Publikë Nr.06/L-114 ku thot: “Ankimi paraqitet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga njoftimi i vendimit” si dhe nën 74 pika 5 ku thot “Nëse ankuesi nuk është i kënaqur me vendimin e organit të ankimit, në afatin vijues prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, mund të iniciojë kontest pune në gjykatën kompetente”.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Drejtorisë së Arsimit, Kryetarit të Komunës, dhe Zyrës për Informim.

Komisioni Ankesave:

1. Idajet Rexhepi _____
2. Minire Halili _____
3. Naim Hasani _____

